



Bastiset një diskotekë në Prishtinë: Kapenthika, fishekë e shkopinj druri



15/07/2023 19:46 [f](#) [t](#) [s](#)

Policia e Kosovës, ka njoftuar se mbrëmë rreth orës 22:00 ka kryer një operacion bastisjeje në rrugën magjistrale Prishtinë-Fushë Kosovë, ku janë gjetur dhe sekuestruar 11 fishekë, dy thika, dy shufra metalike, një jelek antiplumb, një spërkatës dhe pesë shkopinj druri.

Nga PK'ja është bërë e ditur edhe se, në stacionin policor janë shoqëruar gjashtë persona të dyshuar me rekomandim të prokurorit është iniciuar hetim për gjashtë raste të ndryshme penale.

Komunikata e plotë:

Zbatohet një urdhër kontrolli i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 15 korrik 2023 – Policia e rajonit të Prishtinës respektivisht stacioni policor Jugu, mbrëmë rreth orës 22:00, ka kryer një operacion bastisjeje në përputhje me urdhër kontrollin e nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Kontrolli u krye në një lokal (diskotekë), në rrugën magjistrale Prishtinë – Fushë Kosovë, me ç’ rast policia gjeti dhe sekuestroj;

- Njëmbëdhjetë copë fishekë të kalibrave të ndryshëm,
- Dy thika,
- Dy shufra metalike,
- Një jelek antiplumb,
- Një Spërkatës (Sprej), si dhe
- Pesë shkopinj druri.

Në stacionin policor janë shoqëruar gjashtë persona të dyshuar dhe me rekomandimin e prokurorit të shtetit është iniciuar hetim për gjashtë raste të ndryshme penale, ndërsaq të dyshuarit janë proceduar më tej.

LAJME TË FUNDIT



“Ka ikë se e ka rrokë barku, u...

Fero i reagon publikisht Arbenitës: Mos u viktimizo, shihemi në gjyq




Bekim Haxhiu emocionohet kur e sheh Limajn ne protestë



Musliu: Nuk lejojmë të diskutohet me kriminelë serbë për vlerat e UÇK-së


Artikuj të ngjashëm



July 15, 2023
“Ka ikë se e ka rrokë barku, u kthy për Prishtinë”,....



July 15, 2023
Bekim Haxhiu emocionohet kur e sheh Limajn ne protestë



July 15, 2023
Musliu: Nuk lejojmë të diskutohet me kriminelë serbë për vlerat e UÇK-së



July 15, 2023
Pamje: Policia shpërndan ujë për veteranët në protestë



July 15, 2023
Paralajmërojnë veteranët: Protestat nuk do ndalen nëse Osmani dekreton ligjin për...



July 15, 2023
Djali i veteranit: Nuk po di a me thanë “Mirëdita a...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information